

PAKETA
E
INFORMIMIT TE PERGJITHSHEM

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			1 of 18


INFORMACION I PËRGJITHSHEM

Krijuar	Aprovuar	Publikuar	Version:
Dt. __/03/2021	Dt. __/__/____	Dt. __/__/____	1.0
DOMAIN:	Divizioni i Thesari dhe Tregjeve Financiare		
RECEIPTS:	Personi kontaktit:		
	Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Divisions		

HISTORI

PUBLIKIMI	DATË	PERSHKRIM I MODIFIKIMIT
1.0		PUBLIKIM FILLESTAR

DOKUMENTACION I LIDHUR/REFERENCA/ANEKSE

TITULL	Publikuar nga:
1. Ligji Nr 62/2020 "Për tregjet e kapitalit"	 Ligji nr 62-2020

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar:	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			2 of 18

Permbledhje:

1- HYRJE	4
2- BANKA DHE SHËRBIMET E SAJ TË INVESTIMEVE	4
Shërbimet e investimeve të ofruara për klientët	4
3- INSTRUMENTET FINANCIARE DHE RREZIQET	5
A. Të përgjithëshme.....	5
B. Kthimi nga investimi	5
C. Përshkrimi i rreziqeve të përgjithshme të investimeve.....	6
D. Përshkrimi i instrumenteve financiare dhe rreziqeve të ndërlidhura.....	8
4- KATEGORIZIMI I KLIENTËVE	10
5- PËRSHTATSHMËRIA E KLIENTIT	11
6- PROCEDURA PER EKZEKUTIMIN ME TE MIRE TE URDRHAVE.....	12
7- POLITIKA E KONFLIKTIT TE INTERESIT	15
8- RUAJTIA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE DHE E FONDEVE.....	16
9- PRIVATËSIA	18

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar:	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			3 of 18

1- HYRJE

Ky Dokument përmban informacion të përgjithshëm mbi politikat dhe procedurat që zbatohen kur Tirana Bank ("Banka") i ofron Klientit shërbime dhe aktivitete investimi dhe shërbime ndihmëse, në instrumenta financiarë bazur ne ligjin nr 62 2020 "Për tregjet e kapitalit"

Banka rezervon të drejtën e saj për të ndryshuar këtë dokument në çdo kohë. Çdo ndryshim i tillë do të vihet në dispozicion në faqen e internetit të Bankës. <https://www.tiranabank.al>

Ky dokument duhet të lexohet së bashku me kontratën për shërbimet me instrumentat financiarë. Kur ka ndonjë mospërputhje midis përmbajtjes së këtij dokumenti dhe kontratës, kushtet e kësaj të fundit do të mbizotërojnë.

Termet me shkronja të mëdha të cilat nuk janë përcaktuar në këtë dokument do të kenë kuptimin e dhënë atyre në kontratë. Çdo term i përdorur në këtë dokument dhe që nuk interpretohet ndryshe do të ketë kuptimin e atribuar në Ligj.

2- BANKA DHE SHËRBIMET E SAJ TË INVESTIMEVE

Shërbimet e investimeve të ofruara për klientët

Tirana Bank është licensuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti I Mbikqyrjes Financiare në lidhje me veprimtaritë që mund të ushtrojë në Tituj.

Shërbimet dhe aktivitetet e investimeve, si dhe shërbimet ndihmëse, për të cilat Banka është e licensuar të ofrojë, janë si më poshtë:

Shërbimet dhe aktivitetet e investimeve:

- Marrja dhe transmetimi i urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare
- Ekzekutimi i urdhrave në emër të Klientëve
- Tregtimi për llogari të vet

Shërbimet ndihmëse:

Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

Detajet e Bankës:

Tirana Bank Sh.A

Adresa:

Rr. "Ibrahim Rugova"

PO BOX 2400/1

Tirana – ALBANIA

Faqja Website:

<https://www.tiranabank.al>

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			4 of 18

TEL: +355 4 22 77 700

E-MAIL: info@tiranabank.al

3- INSTRUMENTET FINANCIARE DHE RREZIQET

A. Të përgjithëshme

Instrumente të ndryshëm Financiarë përfshijnë nivele të ndryshme të ekspozimit ndaj rrezikut dhe për të vendosur nëse do të tregtojë në ndonjë Instrument Financiar, Klienti duhet të jetë i vetëdijshëm për udhëzimet e paraqitura më poshtë.

Një investim në çdo instrument financiar përfshin rreziqe. Këto rreziqe mund të përfshijnë, ndër të tjera, tregun e kapitalit, tregun e obligacioneve, valutën e huaj, normën e interesit, paqëndrueshmërinë e tregut dhe rreziqet ekonomike, politike dhe rregullatore dhe çdo kombinim të këtyre dhe rreziqeve të tjera.

Klienti duhet të kuptojë rreziqet që lidhen me një investim në një Instrument Financiar dhe duhet të arrijë një vendim investimi, vetëm pasi të shqyrtojë me kujdes:

- i. Natyrën e rreziqeve të përfshira dhe ekspozimin ndaj këtyre rreziqeve; dhe
- ii. Përshtatshmërinë e një investimi në Instrumentin përkatës Financiar duke marrë parasysh pozicionin e tij financiar dhe rrethanat e tij.

Kjo pjesë përshkruan shkurtimisht natyrën dhe rreziqet e Instrumenteve të ndryshme Financiarë, por nuk mund të mbulojë të gjitha rreziqet dhe karakteristikat shoqëruese të Instrumenteve Financiare të përshkuara më poshtë.

Banka me këtë nuk bën asnjë përfaqësim, garanci ose garantim për sa i përket saktësisë ose plotësisë së tyre.

Ekspozimi i rreziqeve që vijon është vetëm **ilustrues** dhe ka për qëllim të ndihmojë në kuptimin e mënyrës së funksionimit të tregjeve të kapitalit dhe faktorët e përgjithshëm që ndikojnë në vlerat dhe çmimet e investimeve. **Ai nuk duhet të konsiderohet i plotë dhe as nuk duhet të interpretohet si Këshillë Investimi ose rekomandim për ofrimin e ndonjë shërbimi ose investimi në ndonjë nga Instrumentet Financiarë të përmendur më poshtë.** Kur klienti është i paqartë për kuptimin e ndonjë prej rreziqeve dhe paralajmërimeve të përshkuara më poshtë, Banka fuqimisht rekomandon që ai të kërkojë këshilla të përshtatshme të pavarura ligjore ose financiare para çdo vendimi investimi.

B. Kthimi nga investimi

Çmimi ose vlera e një investimi në Instrumentet Financiarë mund të ndikohet nga një sërë faktorësh jashtë kontrollit të Bankës dhe Klientit. Vlera e çdo investimi të tillë dhe shuma e të ardhurave që rrjedhin prej tyre mund të rriten ose të ulen dhe mund të bëhen të pavlefshme. Nuk ka asnjë garanci që Klienti do të marrë përsëri shumën që ka investuar fillimisht. Performanca e kaluar e një Instrumenti Financiar nuk është garanci i performancës së tij në të ardhmen.

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			5 of 18

C. Përshkrimi i rreziqeve të përgjithshme të investimeve

Rreziku i tregut: I referohet rrezikut që vlera e një investimi ose e një portofoli investimesh të ulet për shkak të ndryshimeve në faktorët e tregut siç janë normat e interesit, çmimet e aksioneve, indekset e aksioneve, kurset e këmbimit, çmimet e mallrave dhe indekset e mallrave.

Katër faktorët më të zakonshëm të rrezikut të tregut janë si më poshtë:

- Rreziku i çmimit të aksioneve: rreziku i rënies së vlerës së një letre me vlerë ose portofolit
- Rreziku i normës së interesit: rreziku që vlera e një investimi do të ndryshojë për shkak të një ndryshimi në nivelin e normave të interesit, në përhapjen midis dy normave, në formën e kurbës së rendimentit ose në ndonjë marrëdhënie tjetër të normës së interesit.
- Rreziku i këmbimit valutor: rreziku që vlera e një investimi të ndikohet nga ndryshimet në kurset e këmbimit dhe ndikon në investimet në Instrumentet Financiarë të cilat tregtohen në një valutë të ndryshme nga monedha vendasse ose në tregjet e këmbimit valutor.
- Rreziku i mallit: rreziku i çmimit të mallit siç është metali ose misri që ndryshon.

Lëvizjet në aksione ose indekse të tjerë janë gjithashtu faktorë të marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të rrezikut të tregut.

Rreziku i kredisë: Ka të bëjë me rrezikun e dobësisë në përmbushjen e detyrimeve të palës kontraktuese si për shembull pamundësia e pagimit e plote ose të pjesëshem dividendit ose interesit etj. Ky rrezik është i mundur të vlerësohet paraprakisht dhe të kufizohet përmes vlerësimit të kredisë së kunderpartisë. Efekti i rrezikut të kredisë është i shumëfishtë: ai mund të prekë një emetues - dhe rrjedhimisht Instrumentet e tij Financiare - institucionin e kreditit ose kompaninë e investimeve - dhe, si rezultat, të ndikojë në aftësinë paguese - etj.

Rreziku i likuiditetit: Rreziku i likuiditetit është një rrezik financiar dhe shkaktohet nga një mungesë e mundshme e likuiditetit të tregut për një ose më shumë instrumente financiarë. Ka të bëjë me rrezikun e moslikuidimit në kohë dhe me një çmim të arsyeshëm të investimit, i cili rezulton në humbje për Klientin për shkak të paqëndrueshmërisë së çmimeve gjatë periudhës ndërmjet marrjes së porosisë deri në ekzekutimin e tij.

Rreziku sistematik: Rreziku sistematik I referohet rrezikut të një kaskade dështimesh në sektorin financiar, të shkaktuar nga ndërlikimet brenda sistemit financiar, duke rezultuar në një rënie të rëndë ekonomike. Rreziku sistematik reflekton rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar disa apo të gjithë aktoret e tregut, duke patur kështu një ndikim të gjere.

Rreziku jo-sistematik: Rreziku jo-sistematik është rrezik jo-tregu ose specifik i lidhur me një lëshues specifik të letrës me vlerë. Quket gjithashtu rrezik unik ose rrezik i diversifikueshëm pasi mund të eliminohet me diversifikim. Në parim lidhet me pasigurinë e lidhur me kompaninë në të cilën investitori dëshiron të investojë.

Rreziku i Menaxhimit të Portofolit: është rreziku që varet nga strategjia e investimit që po ndiqet ose nga aftësia e menaxherit të portofolit për të vepruar në përputhje me praktikën më të mira të menaxhimit të portofolit.

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			6 of 18

Rreziku operacional: Rreziku që buron nga faktorë të tillë si prishja ose mosfunksionimi i sistemeve thelbësore dhe kontrolleve, përfshirë sistemet IT, rreziku që biznesi drejtohet në mënyrë të paaftë dhe ndryshimet e personelit dhe organizatës mund të kenë një ndikim negativ në të gjitha Instrumentet Financiare, etj.

Likuidimi - Rreziku i shlyerjes: Ka të bëjë me një formë të veçantë të rrezikut të kredisë dhe ndodh për shkak mospermbushjes së detyrimeve të palëve kontraktuese që marrin pjesë në sistemet e pagesave dhe shlyerjen e transaksioneve në Instrumentet Financiarë. Për shembull, kur një nga palet kontraktuese nuk po dorëzon titujt që ka shitur dhe te cilat është i detyruar të dorëzojë, ose në lidhje me blerjen, kur bleresi nuk është duke paguar çmimin e titullit. Në rast se investimi ka të bëjë me produkte që janë objekt negocimi në tregjet e organizuara, ky rrezik kufizohet për shkak të mbikëqyrjes së rreptë të këtyre tregjeve. Ky rrezik rritet në rast se investimi bëhet në lidhje me produktet jashtë bursës.

Rreziku i shtetit: Ky rrezik lidhet me kornizën institucionale dhe rregullatore të shtetit në të cilin po investohen asetet. Ekzistenca e ndonjë paqëndrueshmërie të mundshme politike ose financiare të shtetit të investimit mund të ketë efekte negative mbi Klientin. Sidomos kur bëhet fjalë për investime në tregjet në zhvillim, humbjet mund të ndodhin nga fakti që nuk ka asnjë lidhje të menjëhershme që rezulton në vonesa në ekzekutimin e urdhrave ose për shkak të faktit se është e vështirë që çmimet aktuale të reklamohen menjëherë ose madje edhe për shkak të kushteve të ndryshme të funksionimit të këtyre tregjeve. Pas kërkesës së Klientit, kompania mund t'i sigurojë atij informacion specifik në lidhje me mënyrën e funksionimit dhe rreziqet e rritjes së tregjeve.

Rreziku i zvogëluar i mbikëqyrjes: Ka të bëjë me rrezikun e shtetit dhe i referohet faktit që në disa shtete mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve të investimeve në treg si dhe e sigurimit të organeve të shërbimeve të investimeve mund të jenë joadekuate dhe joefektive.

Rreziku tatimor: Në lidhje me rreziqet të lidhura me taksimin e të ardhurave nga investimet në Instrumentet Financiarë, si dhe çdo ndryshim në legjislacionin tatimor, klienti do të njoftohet nga këshilltari i tij i investimeve në lidhje me produktin përkatës të investimit në të cilin dëshiron të investojë. Nëse një investim përbëhet nga më shumë investime në Instrumente ose shërbime të ndryshme Financiare, është e mundur që rreziqet në lidhje me këtë investim të rriten në krahasim me rreziqet që lidhen me secilin investim veç e veç. Në këtë rast, Klienti duhet të marrë një përditësim të veçantë analitik jo vetëm për natyrën e investimit të tij, por edhe për rreziqet që lidhen me të.

Rreziku i sektorit: Rreziku i sektorit është rreziku kur letrat me vlerë të shumë ndërmarrjeve në të njëjtin sektor do të bien në çmim në të njëjtën kohë për shkak të ngjarjeve që prekin të gjithë industrinë. Faktorët që mund të ndikojnë në industri përfshijnë faktorë ekonomikë, si dhe faktorë unikë të lidhur me industrinë e veçantë.

Rreziku i vendit: Rreziku i vendit është rreziku që lidhet me investimin në një vend të caktuar. Këto rreziqe përfshijnë, ndër të tjera, rrezikun politik, rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun ekonomik të lidhur me vendin specifik.

Rreziku i inflacionit: Ecuria e Indeksit të Përgjithshëm të Çmimeve të Konsumit ndikon në vlerën reale të kapitalit të investuar dhe ecurinë e dëshiruar. Inflacioni mund të gërryëjë në mënyrë efektive vlerën e kthimeve të portofolit dhe mund të zvogëlojë fuqinë blerëse dhe të rezultojë në humbje të vlerës reale.

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			7 of 18

Rreziku i dividendit: Duke investuar në letra me vlerë që paguajnë dividend, investitorët duhet të pranojnë që dividendët e shpërndarë nga kompanitë varen nga politika e kompanisë dhe vendimi i saj për të bërë pagesa të dividendit ose jo. Për më tepër, duhet të theksohet se ekziston rrezik që lidhet me investimin në aksione që paguajnë dividend dhe duhet të tregohet kujdes kur tregtoni këto aksione me dividend ose pa dividend, pasi çmimet e aksioneve mund të bien pas datës ex-divident. Së fundmi, ka raste kur kompanitë mund të vendosin të ofrojnë shpërndarje të dividendit në formën e letrave me vlerë në vend të parave të gatshme dhe të cilat duhet të merren parasysh nga investitorët kur zgjedhin letrat me vlerë që paguajnë dividendin.

Rreziku i parapagimit: I quajtur ndryshe rrezik i shlyerjes së hershme ose rrezik i thirrjes, i referohet rrezikut që lidhet me emetuesin e letrave me vlerë me të ardhurave fikse (ose një instrumenti tjetër financiar me karakteristika të ngjashme) për shlyerjen të një pjeseose të të gjithë emetimit të obligacionit para maturimit.

Rreziku i çmimit: Rreziku i humbjes që ndodh kur çmimi i një Instrumenti Financiar (ose portofoli) bie në të ardhmen, i cili mund të jetë nën çmimin që është paguar për ta blerë atë.

Rreziku i riinvestimit: Gjatë periudhave të rënies së normave të interesit, pagesa e kuponit dhe pagesa e kryegjësë mund të ri-investohen me kthime me të uleta sesa kuponit origjinal i titullit.

Rreziku i këmbimit valutor: Ndryshimet në kundërvlerë të investimit (vlera në monedhe e ndryshme nga monedha baze e klientit me vlerën e investimit në monedhën e tij baze) ndikojnë në vlerën një investimi por edhe në detyrimet dhe kërkesat e biznesit të Klientit, por edhe detyrimet ose kërkesat e bizneseve. Rreziku i monedhës së huaj sipas të cilit vlera e instrumentit financiar të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit në treg.

Rreziku i Kredisë së Derivateve: Ky është rreziku që njëra nga palët e përfshira në një kontratë derivativi të mos paguajë në vlerë me rrezikun që është më i lartë për kontratat OTC krahasuar me kontratat e tregtuara me këmbim. Quhet edhe rreziku i palës tjetër.

D. Përshkrimi i instrumenteve financiare dhe rreziqeve të ndërlidhura

Banka ofron shërbime investimi të cilat çojnë në transaksione në Instrumentet Financiare të mëposhtëm, të cilat përfshijnë rreziqet themelore vijuese:

Aksionet- Një aksion është pjesë e kapitalit aksionar të një shoqërie anonime.. Aksionet mund të jenë të zakonshme ose të privileguara, të emetuara ose anonime, me të drejtë vote ose jo, të negociueshme në një bursë ose të panegociueshme. Aksioni, si një titull, reflekton të drejtat e aksionarit që rrjedhin nga pjesëmarrja e tij në shoqërinë anonime. Këto të drejta zakonisht korrespondojnë me numrin e aksioneve që zotëron aksioneri. Të drejtat treguese që rezultojnë nga pronësia e aksioneve është e drejta e dividendëve nga fitimet e shpërndara të shoqërisë (për atë kohë sa ato mund të shpërndahen), si dhe përqindja përkatëse në pronën e kompanisë në rastin e likuidimit të kompanisë.

Aksioni i zakonshëm- është lloji më i zakonshëm i aksionit dhe përfshin të gjitha të drejtat themelore të një aksioneri, si interesi i pjesëmarrjes në fitime, në emetimin e aksioneve të reja, në likuidim si dhe të drejtat e votës në Asambleshën e Përgjithshme të shoqërisë dhe pjesëmarrjen në menaxhimin e saj.

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			8 of 18

Aksioni i privilegjuar ofron avantazhin / privilegjin ndaj aksioneve të zakonshme që përbën marrjen e privilegjuar të dividendëve ose të drejtave të privileguara në likuidim në rast se kompania likuidohet, por mund të mos ketë të drejtë vote. Sipas rrjedhës dhe rezultateve të kompanisë, aksionarët mund të gëzojnë dividendë nga fitimet e çdo viti të kompanisë në fjalë.

Aksionarët janë të ekspozuar ndaj të gjitha rreziqeve kryesore të përmendura më sipër dhe veçanërisht ndaj rrezikut të tregut dhe kredisë. Aksionet mund të tregtohen në bursa dhe vlera e tyre në treg mund të ulet ose të rritet në përputhje me kushtet e tregut. Në lidhje me aksionet e tregtuara jashtë një burse aksionesh ose aksionet e kompanive më të vogla, ekziston një rrezik shtesë i humbjes së parave kur aksione të tilla blihen ose shiten për shkak të likuiditetit të tyre të ulët. Aksionet e ndërmarrjeve të listuara në tregjet në zhvillim janë më të vështira për t'u blerë dhe shitur sesa aksionet e kompanive të listuara në tregje më të zhvilluara dhe kompani të tilla mund të mos jenë aq të rregulluara. Vihet re se në rastin e shpërbërjes së kompanisë, investitori mund të humbasë të gjithë vlerën e investimit.

Obligacionet (Bonds)

Bond-i është një instrument borxhi, me anë të së cilit emetuesi merr përsipër detyrimin ndaj mbajtësit për të shlyer kapitalin në maturimin e tij dhe interesin (kuponin) në periudhat e specifikuar në kushtet e emetimit. Obligacionet mund të emetohen nga qeveritë (obligacione qeveritare) ose kompani (obligacione të korporatave). Në këtë kuptim, obligacionet përfaqësojnë një formë të huamarrjes së qeverisë ose të korporatave.

Rreziku i kredisë i qeverive, organizatave financiare, korporatave dhe përgjithësisht i çdo emetuesi të obligacioneve mund të vlerësohet nga agjencitë e vlerësimit të kredisë. Rezultati i këtyre vlerësimeve përbën një udhëzues të vlefshëm për investitorët në obligacione. Emetimet e obligacioneve me vlerësime më të ulëta të kredisë kanë tendencë të ofrojnë kuponë më të lartë për të kompensuar investitorët për rrezikun më të lartë që ata marrin. Disa obligacione tregtojnë në bursa të njohura, por shumë tregtojnë jashtë tregut të rregulluar (OTC). Likuiditeti mund të ndryshojë midis llojeve të ndryshme të obligacioneve.

Përveç rrezikut të kredisë kur emetuesi i obligacionit nuk mund të jetë financiarisht i gatshëm për t'u paguar investitorëve interesin ose edhe kryegjënë e obligacioneve dhe / ose kur vlera e obligacioneve mund të ulet pas uljes së vlerësimit të kredisë të emetuesit, ekziston **rreziku i këmbimit valutor, rreziku i likuiditetit, rreziku i normës së interesit dhe rreziku i parapagimit**.

Rreziku i normës së interesit është rreziku kur rritjet në normat e interesit mund të shkaktojnë ulje të konsiderueshme të vlerës së tregut të një obligacioni me normë fikse (rrezik çmimi) dhe kur uljet e normave të interesit mund të ndikojnë në riinvestimin e pagesave të kuponit të një obligacioni me normë fikse (rreziku i riinvestimit). Kur normat e interesit rriten, një Obligacion i emtuar më parë me normë fikse më të ulët mund të ulet në vlerë. Si rezultat, sa më i gjatë të jetë maturiteti (kohëzgjatja) e obligacionit, aq më e lartë është ndjeshmëria e tij ndaj ndryshimeve të normave të interesit. Kur normat e interesit ulen, pagesat e kuponit të marra nga Obligacioni me normë fikse ri-investohen me norma më të ulëta interesi ndërsa pagesat e kuponit të marra nga investitorët nga Obligacionet me normë të luhatshme zvogëlohen.

Rreziku i parapagimit është rreziku i ndryshimit të kthimit të pritshëm të obligacionit në rast se emetuesi ka të drejtë, në përputhje me kushtet e emetimit, ta shlyejë atë më herët në rast të uljes së normave të interesit:

a Obligacione të thirrshme

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			9 of 18

Një Obligacion i thirrshëm i ofron emetuesit mundësinë për të blerë Obligacionin përpara datës së maturimit. Shlyerja mund të jetë e detyrueshme për emetuesin bazuar në përmbushjen e disa parakushteve të përfshira në kushtet fillestare të emetimit ose sipas opsionit të emetuesit dhe e gjithë ose një pjesë e Obligacionve të emetuara mund të shlyhen para datës së maturimit të tij. Investitorët, Obligaciont e të cilëve thirren, paguhen me një çmim të caktuar thirrjeje. Çdo ndryshim (pozitiv) midis çmimit të thirrjes së një obligacioni dhe vlerës nominale është primi i thirrjes. Karakteristikat e thirrjes i ekspozojnë investitorët ndaj rreziqeve shtesë dhe për këtë arsye emetohen me rendimente më të larta sesa obligacionet e krahasueshme pa karakteristika të tilla.

b Obligacione te Konvertueshme

Një Obligacion i Konvertueshëm është një Obligacion korporate që i jep mbajtësit të saj mundësinë për ta shndërruar atë në aksione të kompanisë së emëtuesit në periudha të caktuara kohore dhe me një çmim specifik konvertimi.

c Bonot e Thesarit

Bonot e Thesarit janë instrumenta që emetohen me zbritje nga vlerën e tyre nominale (nominale). Bonot e Thesarit mund të kenë maturitet një muaj, tre muaj (trembëdhjetë javë), gjashtë muaj ose dymbëdhjetë muaj (pesëdhjetë e dy javë). Ato kryesisht i nënshtrohen rrezikut të normës së interesit.

4- KATEGORIZIMI I KLIENTËVE

Ne perputhje me ligjin Nr 62/2020 “Per tregjet e kapitalit”, Tirana Bank përpara se të ofrojë një shërbim investimi ose të kryejë transaksion me klientët e saj, bën kategorizimin e secilit klient dhe trajton secilin klient në një mënyrë që plotëson kërkesat e kategorisë në të cilën klienti është klasifikuar.

Banka kategorizon klientët në një nga kategoritë e mëposhtme sipas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligjin Nr 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”

- Klient profesionist
- Klient joprofesionist
- Klient i kualifikuar
- Palë e pranueshme

- Klient profesionist

Banka kategorizon klientin si profesionist në rastin kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

- a) **Subjekte, të cilave u kërkohet të licencohen ose të njihen për të ushtruar veprimtari në tregjet financiare** (bankat; shoqëritë komisionëre; institucione të tjera financiare të licencuara apo të njohura; shoqëritë e sigurimeve; sipërmarrjet e investimeve kolektive, shoqëritë administruese dhe administruesit e fondeve të investimeve alternative të këtyre sipërmarrjeve; fondet e pensionit vullnetar dhe shoqëritë administruese të këtyre fondeve; tregtuesit e mallrave (commodities) si instrumente financiare dhe të derivativëve të mallrave; shoqëritë vendase, që ofrojnë shërbime investimesh në tituj; investitorë të tjerë institucionalë)

- b) **Shoqëri tregtare, që përmbushin të paktën dy prej tri kriterëve të mëposhtme:**

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			10 of 18

1. Totali i aktivitet sipas bilancit është të paktën 2.6 miliardë lekë;
2. Xhiroja nëto është të paktën 5.2 miliardë lekë; ose
3. Kapitalet e veta janë të paktën 260 milionë lekë, ose sipas përcaktimeve të vendosura nga Autoriteti me rregullore

- c) **Institucionet e qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, organet publike, që administrojnë borxhin publik, banka qendrore, institucionet ndërkombëtare**, si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe organizata të tjera të ngjashme ndërkombëtare
- d) **Investitorë të tjerë institucionalë, veprimtaria kryesore e të cilëve është investimi në instrumente financiare**, përfshirë subjektet që kryejnë aktivitetin e konvertimit të aktiveve në tituj të tregtueshëm ose transaksione të tjera financiare.

- Klient joprofesionist

Banka kategorizon klientin si joprofesionist në rastin kur ky klient nuk është kategorizuar si klient profesionist.

- Klient i kualifikuar

Banka kategorizon klientin si i kualifikuar, kur klienti joprofesionist me kërkesë të tij kërkon të trajtohet si klient profesionist. Në këtë rast klienti duhet të përmbushë të paktën dy prej kriterëve të mëposhtme:

- 1- Klienti ka kryer transaksione në madhësi të konsiderueshme në tregun përkatës, me një frekuencë mesatare prej 10 operacionësh për tremujor përgjatë katër tremujorëve të mëparshëm;
- 2- Madhësia e portofolit të instrumentëve financiarë të klientit, përfshirë depozitat në para dhe instrumentët financiarë, i tejkalon 65 milionë lekët;
- 3- Klienti punon ose ka punuar në sektorin financiar për të paktën një vit në një pozicion profesional, i cili kërkon njohuri të transaksioneve ose shërbimeve të parashikuara.

Për klasifikimin e klientit si i kualifikuar, Banka do të bazohet në deklarinë me shkrim të klientit dhe nuk do të verifikojnë me tej vërtetësinë e deklarinës.

5- PËRSHTATSHMËRIA E KLIENTIT

Banka në varësi të shërbimit të investimit të ofruar dhe kompleksitetit të instrumentit financiar për të cilin kërkohet të kryhet një transaksion vlerëson përshtatshmërinë e instrumentit financiar për klientët e saj përpara ofrimit të shërbimit.

Banka Tirana në rastin e ofrimit të shërbimit të investimit në instrumenta financiare kompleks, do vlerësojë nëse produkti apo shërbimi i ofruar është i përshtatshëm për klientin joprofesionist, të cilët nuk marrin këshilla ose rekomandime. Banka me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit do të kryejë testin e përshtatshmërisë i cili përfshin marrjen e informacionit për njohurinë dhe eksperiencën e klientit në fushën e investimeve për produktin apo shërbimin e ofruar apo të kërkuar.

Nëse shërbimi apo produkti i ofruar rezulton i përshtatshëm për klientin, banka paralajmëron klientin mbi rezultatin e testit nëpërmjet formatit standart. Në rastet kur klientët nuk pranojnë të japin informacionin e kërkuar nga Banka për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre, ose në rastet kur informacioni i ofruar

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			11 of 18

është i pamjaftueshëm, Banka paralajmëron klientët se nuk mund të përcaktojë nëse produkti apo shërbimi i ofruar është i përshtatshëm për të. Paralajmërimi do të behet sipas formatit standard të aprovuar nga Banka

Në çdo rast banka përmbush kërkesën e klientit lidhur me shërbimin/produktin e ofruar, pavarësisht rezultatit të testit të përshtatshmerise. Banka kujdeset për marrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm bazuar ne procedura lidhur me secilin rast në ofrimin e shërbimeve të investimit.

Banka nuk kryhen testin e përshtatshmerisë per klientët e saj, në rastin e ofrimit të shërbimit të marrjes dhe transmetimit dhe/ose ekzekutimit të urdhrave për llogari të klientit, kur shërbimi ka të bëjë me:

- i. Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë
- ii. Aksione, obligacione, obligacione të garantuara dhe forma të tjera borxhit të titulluar të listuara dhe pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. (Përfshihen aksionet që përmbajnë në strukturën e tyre një instrument derivativ, dhe obligacionet ose borxhe të konvertueshme në tituj, që përfshijnë një instrument derivativ ose kanë një strukturë, e cila e bën të vështirë kuptimin e instrumentit nga ana e klientit)

6- PROCEDURA PER EKZEKUTIMIN ME TE MIRE TE URDHRAVE

Detyrimi I Bankes për ekzekutimin më të mirë është për të gjitha tipet e instrumentave financiare, te pershkruar në dokumentacionin informues të përgjithshëm të klientëve për Instrumentet financiare dhe në marrëveshjen individuale të lidhur me ta, si per ato te listuar ne nje burse ashtu edhe per ato te tregtuara ne Tregun mbi Banak (OTC).

Procedura zbatohet për ekzekutimin nga Banka, të urdhrave të Klienteve Joprofesioniste dhe Profesioniste, për Instrumentet Financiare në lidhje me:

- Duke vepruar si ekzekutues i Urdhrave të Klientëve (ekzekuton urdhrin me çmimin më të mirë mbizotërues në treg apo në tregje, për atë madhësi urdhri)
- Duke tregtuar për llogari te vet (ekzekuton urdhrin me një çmim më të mirë për klientin sesa po ta kishte ekzekutuar urdhrin sipas pikes se pare)
- Duke Vepruar si marrës dhe transmetues i Urdhrave të Klientit; (zbaton masa efektive për të përmbushur detyrimin e ndjekjes së të gjithë hapave të duhur për të siguruar rezultatet më të mira të mundshme për klientët)

Kjo procedure nuk zbatohet në rastet e mëposhtme:

- a) Nëse klienti është klasifikuar si një Palë e Pranueshme, Banka nuk do t'i detyrohet Ekzekutimit më të Mirë për transaksionet e kryera. Megjithëse Procedura e Ekzekutimit me të mire te urdhrave nuk zbatohet në raste të tilla, Banka do të veprojë me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm dhe do të komunikojë në një mënyrë, e cila është e drejtë, e qartë dhe jo mashtruese, duke marrë parasysh natyrën e klientit dhe biznesit të tij.
- b) Nëse klienti ka dhënë udhëzime specifike për ekzekutimin e urdhërit të tij.

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			12 of 18

Klientëve u theksohet se sigurimi i disa udhëzimeve për ekzekutim mund të parandalojë Bankën nga marrja e masave të parashikuara në Politikën e Ekzekutimit me te mire të Urdhrave për arritjen e rezultatit më të mirë të mundshëm gjatë ekzekutimit të urdhrave të tyre. Në rast se udhëzimet e klientit kanë të bëjnë vetëm me një pjesë të urdhërit, Banka do të zbatojë Politikën e Ekzekutimit me te mire të Urdhërave për pjesën tjetër të urdhërsë.

- c) Nëse urdhërat kanë të bëjnë me produkte të cilat nuk kanë nje cmim te kuotuar
- d) Në rast të një forcë madhore e cila ndikon, ndërpret ose ndalon (përgjithmonë ose përkohësisht) funksionimin e tregut të organizuar ose platformen e ekzekutimit Në rrethana të tilla të jashtëzakonshme, megjithatë, Tirana Bank do të përpiqet të ekzekutojë urdhrin, duke marrë parasysh rrethanat mbizotëruese, mbi bazën e përpjekjeve më të mira.

Faktoret e ekzekutimit

Banka do të vlerësojë çdo urdhër për të përcaktuar rëndësinë relative të faktorëve të përmendur më poshtë, duke marrë parasysh karakteristikat në kontekstin e:

1. Karakteristikat specifike të secilit klient (Klient Joprofessionist ose Profesionist);
2. Karakteristikat dhe natyra e urdherit (përfshirë nëse jepen udhëzime specifike nga klienti);
3. Karakteristikat e Instrumenteve Financiare të cilat janë objekt I urdherit dhe
4. Karakteristikat e platformave të ekzekutimit ku do të ekzekutohet urdheri.

Banka, kur ekzekuton urdhrat e Klientëve, merr parasysh faktorë të ndryshëm, pasi qëllimi është që të arrihet rezultati më i mirë i mundshëm për klientët e saj. Faktorët kryesorë që merren në konsideratë në secilin rast, për të siguruar që rezultati më i mirë i mundshëm është i siguruar janë si më poshtë:

- Çmimi: çmimi me të cilin ekzekutohet urdheri;
- Kosto: të gjitha kostot përkatëse në lidhje me urdherin;

Këto kosto do të përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ekzekutimin e urdherit, përfshirë çmimin e instrumentit, tarifat e vendit të ekzekutimit, tarifat e shlyerjes, dhe çdo tarifë tjetër e paguar palëve të treta që marrin pjesë në ekzekutimin e urdhërit. Ne kostot totale përfshihen dhe komisionet e Bankes për ofrimin e shërbimit (kontrate dhe kushtet e përgjithshme të punës).

Shpejtësia në ekzekutimin e urdhrit: shpejtësia me të cilën ekzekutohet urdhri;

- Mundësia e ekzekutimit dhe zgjidhjes: gjasat që urdhri të ekzekutohet me sukses;
- Madhësia e urdherit;
- Ndikimi i mundshëm i tregut;
- Natyra e urdherit;
- Aftësia e platformave të ekzekutimit për të menaxhuar urdhërat e dhënë; dhe
- Çdo konsideratë tjetër në lidhje me ekzekutimin e urdhrit

Kriteret cilësore specifike për të shtuar një Platforme ekzekutimi ose ndërmjetësues në listen e miratuar.

Kriteret cilësore specifike për të shtuar një Platforme ekzekutimi ose ndërmjetësues në Listën e Miratuar ndryshojnë bazuar në klasën e aseteve që do të tregtohet, por procesi i përgjithshëm zbatohet në të njëjtën mënyrë në të gjitha klasat e aseteve.

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			13 of 18

Kriteret për të shtuar një Platforme ekzekutimi ose ndërmjetësues në Listën e Miratuar zakonisht bazohen në vlerësimin e një numri faktorësh sasiorë dhe cilësorë që mund të përfshijnë (sipas rastit), por nuk kufizohen në, analizën e Tirana Bank mbi ndërmjetësit ose Platformes së ekzekutimit:

- Konkurrenca e normave të komisionit ose spread-eve;
- Shpejtësia e ekzekutimit;
- Aftësitë e klerimit dhe të shlyerjes;
- Cilësia e shërbimit;
- Risku i Kredise se kunderpartise;
- Përvoja;
- Reputacioni;
- Stabiliteti financiar;

Trajtimi i urdhrave të klientit

Tirana Bank do të sigurohet se ndërmjetësit (brokers) që do të përdoren për vendosur ose transmetuar urdhrat e klienteve të kenë në përdorim një procedurë të ekzekutimit me të mirë të urdhrave.

Gjatë ekzekutimit të urdhrave të Klientëve, Banka do të:

- Ekzekutojë se pari urdhrat e klienteve sipas instruksionit të përcaktuar në urdherin e dhënë nga klienti për kryerje transaksionesh përpara se të kryejë transaksione me të njëjtin instrument financiar për llogari të vet.
- Sigurohet që urdhrat e ekzekutuar në emër të Klientëve të regjistroheshin dhe shpërndaheshin menjëherë dhe saktë.
- Klienti do të informohet në përputhje me rrethanat për çdo vështirësi materiale që mund të ndikojë në ekzekutimin e duhur të urdherit të tij, menjëherë pasi Banka të bëhet e vetëdijshme për vështirësinë.
- Urdhrat të lidhur me transaksione jashtë tregjeve të organizuara ose Platformave Shumepaleshe të tregtimit do të ekzekutohen vetëm nëse Banka ka marrë më parë pëlqimin me shkrim të Klientit.
- Nëse klienti nuk ka deklaruar qartë dhe me shkrim ndryshe, kur klienti vendos një urdher kufi, për tregtim në një treg të rregulluar për blerjen dhe shitjen e një Instrumenti Financiar me çmim të përcaktuar ose me një çmim me të mirë dhe për një sasi të përcaktuar, dhe ky urdher nuk mund të ekzekutohet menjëherë, në kushtet ekzekutive të tregut, Banka do të marrë masat e lidhura me berjen publike të urdherit pa vonesë duke ja bërë të ditur bankave të tjera, me qëllim ekzekutimin sa më të shpejtë të urdherit.

Përfundimet do të bëhen vetëm në rastet e mëposhtme:

- Nëse Klienti ka dhënë udhëzime të veçanta;
- Nëse karakteristikat e urdherit të klientit ose kushtet e tregut kërkojnë trajtim të ndryshëm; dhe.
- Nëse interesat e veçantë të Klientit kërkojnë trajtim të ndryshëm

Kunderpartitë me të cilat Tirana Bank, momentalisht kryen veprime në instrumente financiare (Obligacione) janë:

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			14 of 18

1. Piraeus Bank S.A
2. Raiffeisen Bank International
3. Banca Promos SA
4. Interkapital Vrijednosni Papiri Doo
5. Adamant Capital Partners AD

Kjo liste mbetet gjithnje ne process perditesimi.

7- POLITIKA E KONFLIKTIT TE INTERESIT

A. Hyrje

Banka ka vendosur kontrolle, politika dhe procedura për të identifikuar dhe parandaluar ose menaxhuar konfliktin e interesit midis saj dhe klientëve të saj, si dhe midis një klienti dhe një tjetri, që lindin si rezultat i ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve nga ana e Bankës dhe / ose ndonjë shërbim tjetër bankar për klientët e saj. Punonjësit pritët të dinë detajet e këtyre politikave themelore dhe të jenë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në ato politika dhe procedura.

Kjo politikë është krijuar, për të siguruar që Banka identifikon rrethana të caktuara, kur siguron shërbime investimi dhe aktivitete dhe shërbime ndihmëse dhe / ose ndonjë shërbim tjetër bankar, të cilat mund të shkaktjnë konflikte interesi që sjellin rrezik të dëmtimit të interesave të Klientëve të saj, dhe përcakton rregullimet e Bankës në lidhje me identifikimin dhe parandalimin ose menaxhimin e konflikteve të tilla.

B. Cilat janë konfliktet e interesit

Një konflikt interesi lind kur dy ose më shumë persona kanë interes konkurrues dhe detyra e kujdesit ose besimit ekziston midis atyre personave. Një Punonjës mund të përballet me një konflikt interesi gjatë punës në Bankë, i cili mund të ketë potencial për të kompromentuar ose paragjykuar gjykimin dhe objektivitetin e tyre profesional ose përndryshe pengon kryerjen e duhur të detyrave dhe përgjegjësisë që i detyrohen Punonjësit Bankës. Mosnjohja dhe menaxhimi i duhur i konfliktit të interesit mund të rezultojë në pasoja të papërshtatshme ose të pafavorshme për Klientët, Bankën dhe Punonjësit.

C. Konfliktet e interesit të rëndësishme për Bankën përfshijnë ato që lindin midis:

- a. bankes dhe një ose më shumë klientëve;
- b. një punonjës dhe një klient;
- c. dy ose më shumë klientë në kontekstin e ofrimit të shërbimeve nga Banka për ata klientë;
- d. një punonjësi dhe bankes;
- e. njësitë individuale të Bankës;
- f. Punonjësit individualë të Bankës;
- g. një aksionari dhe Bankes; ose
- h. bankes dhe shitësit e saj dhe / ose përfaqësuesit e palëve të treta

Regjistri i konflikteve

Banka mban dhe shqyrton rregullisht Regjistrin e Konflikteve për llojet e konflikteve të interesit që sjell rrezikun e dëmtimit të interesave të një ose më shumë klientëve që kanë lindur ose mund të lindin në lidhje me sigurimi i shërbimeve dhe aktiviteteve të investimeve dhe shërbimeve ndihmëse dhe / ose ndonjë shërbim tjetër bankar ("Regjistri i Konflikteve"). Informacioni që përmbahet në Regjistrin e Konflikteve

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			15 of 18

lehtëson identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin efektiv të konflikteve të mundshme të interesit dhe ofron një bazë për trajnimin e Punonjësve.

Mospranim veprimi

Nëse Banka vlerëson se konflikti i interesit nuk mund të parandalohet ose menaxhohet në ndonjë mënyrë tjetër, ajo mund të vendosë të refuzojë të veprojë për një Klient, ose të mos kryejë më një aktivitet të veçantë ose të ofrojë një shërbim të veçantë.

Ndarja e funksioneve të biznesit

Nëse një linjë e caktuar biznesi brenda Bankës ka dy ose më shumë funksione brenda asaj linje biznesi që mund të çojë në një konflikt të mundshëm interesi, Banka mund të ndajë këto funksione për tu menaxhuar veçmas nga anëtarë të ndryshëm të stafit.

Zbulimi i konflikteve të interesit

Kur rregullimet organizative dhe administrative të Bankës të krijuara për të identifikuar dhe parandaluar ose menaxhuar atë konflikt interesi nuk janë të mjaftueshme për të siguruar, me besim të arsyeshëm, se rreziqet e dëmtimit të interesave të Klientit do të parandalohen, Banka si një masë e fundit, do t'i zbulojë Klientit konflikte të tilla interesi, përmes një mediumi të qëndrueshëm. Zbulimi duhet të:

- Zbulojë natyrën e përgjithshme dhe / ose burimin e konfliktit të interesit;
- Të sigurojë përshkrim specifik të konfliktit të interesit që lind në sigurimin e shërbimeve të investimeve.
- Shpjegojë rreziqet për Klientin që lindin si rezultat i konfliktit të interesit dhe hapat e ndërmarrë për të zbutur këto rreziqe.
- Mundësojë që Klienti të marrë një vendim të informuar në lidhje me shërbimin ose aktivitetin që krijon konflikt interesi, përpara se Banka të ndërmarrë biznes në emër të saj.

Në rast se Klienti nuk dëshiron që Banka të veprojë në emër të tij në rrethana të tilla, ai duhet të informojë Bankën me shkrim në përputhje me rrethanat.

Rishikimi

Banka do të vlerësojë dhe rishikojë periodikisht, mbi të paktën një bazë vjetore, dhe kurdo që konsiderohet e nevojshme politikën e saj të konfliktit të interesit dhe do të marrë të gjitha masat e duhura për të adresuar çdo mangësi.

8- RUAJTIA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE DHE E FONDEVE

A. Banka, kur mban Instrumente Financiare të Klientit dhe fonde të tyre, merr masa të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e tyre dhe për të mbrojtur të drejtat e pronësisë së Klientit. Për këtë qëllim Banka:

- Mban regjistra dhe llogari duke e bërë të mundur që në çdo kohë dhe pa vonesë të dallojë pasuritë e mbajtura në emër të Klientit nga pasuritë e mbajtura për çdo Klient tjetër si dhe nga pasuritë e saj, me anë të llogarive të titulluara ndryshe në librat e Bankës;
- Mban regjistrat dhe llogaritë e tij në një mënyrë me të cilën siguron saktësinë dhe në veçanti perkatesinë e tyre me Instrumentet Financiare dhe fondet e mbajtura në emër të Klientit;

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			16 of 18

- Kryen në mënyrë të rregullt, reconcilimet ndërmjet llogarive të saj të brendshme dhe regjistrave dhe atyre të ndonjë pale të tretë nga e cila mbahen ato pasuri;
- Merr hapat e nevojshëm për të siguruar që Instrumentet Financiare të Klientit të depozituar te një palë e tretë të identifikohen veçmas nga Instrumentet Financiarë që i përkasin Bankës dhe nga Instrumentet Financiarë që i përkasin asaj pale të tretë, me anë të llogarive të titulluara ndryshe në librat e palës së tretë ose të tjera masa ekuivalente me të cilat arrihet i njëjti nivel i mbrojtjes.
- Realizon rregullime të përshtatshme organizative për të minimizuar rrezikun e humbjes ose zvogëlimin të aktiveve ose të drejtave të Klientit si rezultat i keqpërdorimit të pasurive, mashtrimeve, administrimit të dobët, mbajtjes tjo të përshtatshme të evidencave ose neglizhencës.

B. Kur Instrumentet Financiare të Klientit janë depozituar për tu ruajtur në Bankë, Banka do të ushtrojë të njëjtën shkallë të kujdesit sikur të ishte pronë e saj.

C. Kur Instrumentet Financiare janë depozituar për ruajtje te një palë e tretë e zgjedhur nga Banka, Banka do të përdorë të gjithë aftësinë, kujdesin dhe angazhimin e duhur në zgjedhjen, emërimin dhe rishikimin periodik të palës së tretë dhe rregullimet për mbajtjen dhe ruajtjen e Instrumentave Financiare të Klientit.

D. Banka do të depozitojë Instrumentet Financiare të Klientit vetëm tek një palë e tretë në një juridiksion ku ruajtja e Instrumenteve Financiare për llogari të një personi tjetër i nënshtrohet rregullave dhe mbikëqyrjes specifike, dhe ajo palë e tretë i nënshtrohet kësaj rregulloreje dhe mbikëqyrjeje specifike.

E. Banka nuk depoziton Instrumentet Financiarë të mbajtur në emër të Klientëve të saj te një palë e tretë në një vend të tretë që nuk rregullon mbajtjen dhe ruajtjen e Instrumenteve Financiare për llogari të një personi tjetër, përveç nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a. natyra e Instrumenteve Financiare ose e shërbimeve të investimeve të lidhura me ato Instrumente Financiarë kërkon të depozitohen te një palë e tretë në atë vend të tretë;

b. kur Instrumentet Financiarë mbahen në emër të një Klienti Profesional, ose të një Pale tjetër të Kualifikuar dhe nese ai Klient i kërkon Bankës me shkrim qe t'i depozitojë ato instrumente te një palë e tretë në atë vend të tretë.

Në një rast të tillë, Instrumentet Financiarë do t'i nënshtrohen ligjeve të atij vendi të tretë dhe të drejtat e Klientit në lidhje me investimet e tij mund të jenë të ndryshme nga ato ekzistuese në Shqipëri.

F. Në rast se kujdestari i palës së tretë është në një juridiksion jashtë Shqipërisë, Instrumentet Financiarë që janë depozituar te kujdestari i palës së tretë, do t'i nënshtrohen ligjit të juridiksionit që rregullon kujdestarin e palës së tretë, dhe të drejtat e Klientit në lidhje me Instrumentet Financiarë mund të ndryshojnë nga ato ekzistuese në Shqipëri.

G. Kur Instrumentet Financiare të klientit mbahen nga një kujdestar i palës së tretë në një llogari të omnibus, kjo mund të rezultojë që pronësia e Instrumenteve Financiare të mos identifikohet veçmas në librat e kujdestarit të palës së tretë dhe, në rast të paaftësisë paguese të pales se tretë, Instrumentet Financiarë në fjalë mund të jenë pjesë e pasurisë së palës së tretë.

H. Në rast se Instrumentet Financiare të Klientit depozitohen për ruajtje te një palë e tretë, kjo e fundit mund të ketë , barrë ose të drejtë të shlyerjes në lidhje me këto Instrumente Financiare. Sidoqoftë, një palë e tretë nuk mund të ushtrojë, barresim ose të drejta të shlyerjes mbi Instrumentet Financiare të Klientit dhe / ose fondet që i mundësojnë palës së tretë të disponojë me Instrumentet Financiare dhe / ose fondet, në mënyrë që të rimarrë borxhet që nuk lidhen për Klientin ose ofrimin e shërbimeve për të, përveç nëse kjo kërkohet

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			17 of 18

nga ligji i zbatueshëm në juridiksionin e një vendi të tretë në të cilin mbahen Instrumentet Financiare dhe / ose fondet.

I. Banka nuk do të realizojë marrëveshje të kolateralit financiar me Klientë me Pakicë me qëllim sigurimin ose mbulimin e detyrimeve aktuale ose të ardhshme, aktuale ose të ose të mundshme të Klientëve.

J. Banka nuk autorizon përdorimin e Instrumenteve Financiare të mbajtura nga Banka në emër të Klientit për llogarinë e vetë Bankës ose llogarinë e ndonjë personi tjetër.

9- PRIVATËSIA

Tirana Bank Sh.A është e angazhuar për të mbrojtur dhe respektuar privatësinë dhe të drejtat e Klientit, në lidhje me të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara për sigurimin e produkteve dhe shërbimeve të saj.

Banka Tirana mbledh, ruan depoziton dhe përdor të dhënat personale të deklaruara, në respektim të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Më shumë informacion mbi njoftimin e privatësisë së Tirana Bank mund të merren nga faqja e internetit e Bankës.

<https://www.tiranabank.al/media/1559821668dataprivacynotice.pdf>

Krijuar:	Rishikuar:	Aprovuar	Faqe
Penesta Gjoka Head, Treasury & Financial Markets Division			18 of 18